REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 84/17
Datë/Datum. 03.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 84/17

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, si dhe duke pasur parasysh nenin 5, 108/A dhe 109 të LPP-së, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE "Studio Hapsira Sh.p.k" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hartimi i projekteve - Dokumentacioni teknik për nevojat e Komunës së Graçanicës", me nr prok:"160/79/221", të iniciuar nga autoriteti kontraktues -"Kuvendi Komunal i Graçanicës".

V E N D I M

I. **Hedhet,** poshtë si e pa afatshme ankesa e OE "Studio Hapsira Sh.p.k" - Prishtinë, me nr. të prot. 84/17, e datës 24 mars 2017, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hartimi i projekteve - Dokumentacioni teknik për nevojat e Komunës së Graçanicës", me nr. të prokurimit:"160/79/221", të iniciuar nga autoriteti kontraktues – "Kuvendi Komunal i Graçanicës", pasi që është parashtruar jashtë afatit ligjor tek Autoriteti Kontraktues.

II. **I Lejohet,** autoritetit kontraktues /Kuvendi Komunal i Graçanicës/, që të vazhdoj më tutje procedurat lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hartimi i projekteve - Dokumentacioni teknik për nevojat e Komunës së Graçanicës", me nr. të prokurimit: "160/79/221".

III. Operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës, në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa nuk është shqyrtuar.

IV. **Obligohet,** OE ankues që konform nenit 36 pika 5 e Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 10.03.2017.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 23.03.2017, ku kanë marr pjesë pesëmbëdhjetë (15) operatorë ekonomik.

Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm është bërë me dt:10.03.2017.

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me dt:10.03.2017, e ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "ENG GROUP" nga Prishtina.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës, operatori ekonomik "Studio Hapsira Sh.p.k" - Prishtinë, me dt:15.03.2017, në orën 23:50, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt:16.03.2017, autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Studio Hapsira Sh.p.k" – Prishtinë si e pa afatshme.

Pas verifikimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se ankesa e Operatorit Ekonomik ankues "Studio Hapsira Sh.p.k" - Prishtinë, është parashtruar jashtë afatit ligjor tek autoriteti kontraktues për faktin se AK-ja ka njoftuar OE ankues me letër standarde për tenderues të pa suksesshëm me datën **10 mars 2017** dhe poashtu edhe njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me datën **10 mars 2017**, kurse OE ankues kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar me datën **15 mars 2017**, në orën 23:50 duke tejkaluar afatin kohor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Sipas nenit 108/A të LPP-së në fuqi dhe sipas nenit 4 të *Rregullave për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave*, kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet të dorëzohet tek autoritetit përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve si në vijim, pika **b)** "*kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontrate ose të një konkursi te projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit*".

Kurse neni 5 i LPP-së e rregullon çështjen e afateve kohore e ku në paragrafin 1 të këtij neni ceket që "*Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon* ***deri në 16:00 në ditën e skadimit.*** *Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit*". Pra sipas këtij neni afati për parashtrim të ankesës ka qenë ora 16 e datës 15 mars 2017, kurse operatori ekonomik ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim pas orës 16:00, pra në ora 23:50.

Andaj, Kryetari i OSHP-së, duke u bazuar në faktet dhe provat e prezantuara ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim e dorëzuar nga OE ankues tek autoriteti kontraktues është jashtë afatit ligjor konform nenit 5 dhe 108/A të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur nuk mund të ushtron ankesë, por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë kërkesë-padi në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative.

Kryetari i OSHP-së

Z. Blerim DINA

Vendimi i dorëzohet:

1. 1x1 AK- "Kuvendi Komunal i Graçanicës"
2. 1x1 OE- "Studio Hapsira Sh.p.k" - Prishtinë
3. Arhivës së OSHP-së